

Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant për Specialist në Sektorin e Prokurimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve, Investimeve dhe të Mirëmbajtjes, Rektorati i UPT-së, si më poshtë:

Kriteret për kandidim janë:

1. Kriteria të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Specialist i Prokurimeve.

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike/Juridike ose Shkenca Inxhinierike.
- b) Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune në fushën e prokurimeve.

2. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Specialist i Prokurimeve.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
- 2. Jetëshkrimin (cv) sipas formatit standard;
- 3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- 4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar;
- 5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
- 6. Vetë deklarin e gjendjes gjyqësore;
- 7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **02.09.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.